



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë Praktike B

Ngarkesa: 8 ECTS, 80 orë seminare
Tipologjia e lëndës: (A)
Semestri kur zhvillohet: Viti I /semestri I
Lloji i lëndës: e detyrueshme
Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”
Kodi i Etikës: Kodi i Etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të përvetësojë njohuri të elementeve gjuhësore të frëngjishtes, në planin leksikor, sintaksor dhe gramatikor duke respektuar specifikat fonetike;

Të zhvillojë aftësitë e vëzhgimit dhe analizës, si dhe shumë strategji të të nxënit që do të çojnë progresivisht drejt autonomisë gjuhësore; Të zhvillojë aftësitë për të zgjedhur dhe përdorur shprehjet dhe strukturat për t’u prezantuar, për të folur për veprimtaritë dhe zakonet, për të përshkruar, për t’u vendosur në kohë dhe hapësirë, për të shprehur shijet dhe mendimet, për të kërkuar dhe dhënë informacione, për të folur për ngjarje të shkuara dhe të ardhme.

Objektivat e specifike lëndore:

1.Të zhvillojnë aftësinë për të kuptuar dhe për të shprehur mendime me gojë dhe me shkrim në gjuhën frënge, përmes temave të aktualitetit dhe materialeve autentike.

2.Të përvetësojnë dhe të përdorin në mënyrë aktive strukturat gjuhësore (gramatikë, fjalor, regjistra gjuhësore) për të komunikuar në situata reale ndërkulturore.

3.Të nxisin ndërveprimin dhe pjesëmarrjen aktive në klasë përmes diskutimeve, prezantimeve dhe detyrave individuale apo në grup që kërkojnë mendim kritik dhe kreativitet.